

FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

HIDROKLORTIAZID

Tableta - 25 mg
(Hidroklortiazid)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Hidroklortiazid dhe përse përdoret?
- Përpara se të merrni Hidroklortiazid
- Si ta merrni Hidroklortiazid?
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Hidroklortiazid?
- Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË HIDROKLORTIAZID DHE PËRSE PËRDORET?

Hidroklortiazidi, sikurse të gjithë diuretikët tiazidikë, e shton jashtëqitjen urinare të natriumit dhe kaliumit në sasi afërsisht barazvlerëse. Si veprime të tjera mund të përmenden: jashtëqitja e joneve të kaliumit dhe atyre hidrojenkarbonat, ulja e jashtëqitjes së kalciumit dhe mbajtja e acidit urik. Në doza terapeutike maksimale të gjithë diuretikët tiazidikë janë afërsisht të barabartë përsa i përket veprimit diuretik. Mekanizmi i saktë i veprimit të Hidroklortiazid ende nuk është sqaruar plotësisht. Zona e veprimit të barit është gyphi renal periferik dhe pjesa ngjyese e ansës Henle. Bari frenon enzimin karboanhidrazë, duke ndikuar kështu në bartjen e hidrojen-karbonateve në veshka. Nuk ushtron asnjë ndikim në presionin arterial normal. Efekti antihipertensiv në stadin fillestar lidhet me uljen e vëllimit të lëngut jashtëqelizor. Për veprimin antihipertensiv janë të nevojshme disa ditë. Për të arritur efektin terapeutik optimal janë të nevojshme 2 – 4 javë.

Hidroklortiazid – tableta përdoret në:

- mjekimin e edemave;
- insuficiencën kardiake kongjестive, sëmundje të veshkave, si: sindromi nefrotik;
- cirrozën e mëlçisë;
- mjekimin e hipertensionit, i vetëm ose i kombinuar me barna të tjera antihipertensive.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Hidroklortiazid për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Hidroklortiazid.

2. PËRPARA SE TË MERRNI HIDROKLORTIAZID

Mos merrni Hidroklortiazid:

- në qoftë se keni alergjik ndaj hidroklortiazidit ose diuretikëve të tjerë, rrjedhës sulfamidik;
- në qoftë se keni alergjik ndaj ndonjërit nga përbërësit e tjerë të Hidroklortiazid;

- në qoftë se vuani nga anuria;
 - në qoftë se vuani nga insuficiencia renale;
 - në qoftë se vuani nga insuficiencia e rëndë hepaticë;
 - në qoftë se vuani nga hipokalemia, hiponatremia, hiperkalcemia dhe hiperuricemia;
 - për mjekimin e hipertensionit gjatë shtatzënisë.
- Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë gjatë marrjes së Hidroklortiazid

Të sëmurët që mjekohen me Hidroklortiazid ose me diuretikë të tjerë tiazidikë, në përgjithësi duhet të marrin sasi të mjaftueshme kaliumi, duke përdorur një dietë të pasur me kalium (fruta të thata, patate, domate) ose mjekim (klorur kaliumi).

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- vuani nga sëmundjet e veshkave apo të mëlçisë;
- vuani nga insuficiencia kardiake kongjестive e rëndë, dhe jeni edematozë, sepse në këto raste mund të shfaqet hiponatremi, sidomos kur përdoren doza të larta dhe kufizohet kripa;
- keni shenja të diabetit (këputje, etje, marrje mendsh, etj.) gjatë mjekimit me Hidroklortiazid sepse diabeti latent mund të dalë nga latencia gjatë mjekimit me diuretikë tiazidikë;
- jeni diabetikë që përdorni insulinë, në këtë rast duhet të ndiqni me kujdes përqëndrimet e glukozës në gjak, sepse nevojat për insulinë mund të ndryshojnë gjatë mjekimit me Hidroklortiazid;
- keni hiperuricemi, gjë që mund të shkaktojë krizat e gutës (në të sëmurët me gutë duhet të ndiqen me kujdes, me intervale të rregullta, përqëndrimet e acidit urik në serum);
- vuani nga sëmundje të zemrës ose sëmundje të tjera; përdorimi i Hidroklortiazid duhet mënjëruar në qoftë se ekzistojnë alternativa më të sigurta;
- keni patur cancer të lëkurës ose nëse ju shfaqet një lezion i papritur në lëkurë gjatë trajtimit; trajtimi me hidroklortiazid, veçanërisht ai afatgjatë dhe me doza të larta, mund të rrisë risun për disa tipe të cancerit të lëkurës dhe buzëve (cancer i lëkurës jo-melanomë).

Mbroni lëkurën nga ekspozimi ndaj diellit dhe rrezeve UV ndërkohë që merrni Hidroklortiazid.

Marrja e barnave të tjera

Barna të ndryshëm mund të ndikohen nga Hidroklortiazid ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron, ndaj në përdorimin e njëkohshëm të tyre mund të jetë e nevojshme të ulet ose të rritet sasia e Hidroklortiazid. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë. Njoftoni mjekun tuaj nëse jeni duke marrë dhe barna të tjera, përfshirë ato që mund të merren pa përshkrimin e mjekut.

Hidroklortiazid dhe diuretikët e tjerë tiazidikë mund të ndikojnë në veprimin e të gjithë këtyre barnave:

- allopurinolit, anesteziqëve, antikoagulantëve, antigutozëve, antineoplastikëve, kripërave të kalciumit, glikozideve digitalike, insulinave, litiumit, diuretikëve të ansës, metildopës, miorelaksantëve jodepolarizues, vitaminës D.

Barna që ndikojnë në veprimin e Hidroklortiazid dhe të diuretikëve të tjerë janë:

- amfotericina B, antikolinergjikët, kortikosteroidët, metenamina (hekzametilentetramina) dhe antiinflamatorët josteroidikë.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të mbeteni shtatzënë. Hidroklortiazid dhe të gjithë diuretikët tiazidikë nuk duhen përdorur për mjekimin e hipertensionit gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri. Bari jashtëqitet me qumështin e gjirit dhe mund ta frenojë laktacionin, prandaj ai duhet mënjëruar gjatë periudhës së ushqyerjes së fëmijëve me gji.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Hidroklortiazid

Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontakti mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI HIDROKLORTIAZID?

Gjithmonë merreni Hidroklortiazid sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontakti me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Hidroklortiazid janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Dozimi për tabletat është si vijon:

Të rriturit

Edemat: Doza fillestare është 25 mg deri në 50 mg në ditë për disa ditë, kurse doza mbajtëse është 25 mg deri në 100 mg në ditë ose një ditë po, një ditë jo; të sëmurët rezistentë mund të përdorin deri në 200 mg në ditë.

Hipertensioni: Doza fillestare është 50 mg në ditë, si dozë e vetme ose në 2 doza të ndara. Dozat më të larta se 50 mg shpeshherë shoqërohen me ulje të theksuar të kaliumit në serum. Për të sëmurët që përdorin njëherësh edhe antihipertensivë të tjerë, zakonisht nuk nevojiten doza më të larta se 50 mg.

Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Hidroklortiazid për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni i sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

Tabletat Hidroklortiazid duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Hidroklortiazid

Në qoftë se keni marrë më shumë Hidroklortiazid se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontakti mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Hidroklortiazid

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.

Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:

- çrregullime gastrointestinale (anoreksi, irritim gastrik, të përziera, të vjella, dhimbje barku, fryrje, diarje, konstipacion, pankreatit, sialadenit, tharje goje);
- çrregullime në sistemin nervor qendror (marrje mendsh, dhimbje koke, parestezi, dobësi, pagjumësi, lodhje);
- çrregullime hematologjike (leukopeni, trombocitopeni, agranulocitozë, anemi aplastike ose hiperplastike, anemi hemolitike, anemi megaloblastike);
- hipotension ortostatik;
- impotencë, ulje e libidos;
- nefrit intersticial, azotemi, rritje e azotit ureik në gjak dhe e kreatininës;
- ikter, çrregullim i enzimave të mëlçisë;
- hiperglicemi, glukozuri, hiperuricemi, hipokalemia, hipokloremi, hiponatremi;
- turbullim i të parit, ksantopsi, krampe ose spazma muskulore, ethe dhe reaksione anafilaktike;
- kancer i lëkurës dhe i buzëve (cancer i lëkurës jo – melanomë) (frekuencë e panjohur).

Kur efektet anësore janë të prapësueshme, mjekimi nuk ndërpritet. Kur këto efekte janë mesatare ose të rënda, doza e Hidroklortiazid duhet ulur ose mjekimi duhet ndërprerë. Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI HIDROKLORTIAZID?

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni Hidroklortiazid pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Hidroklortiazid – Tableta 25 mg

Lënda vepruese është hidroklortiazid. Çdo tabletë përmban 25 mg hidroklortiazid. **Përbërësit e tjerë** janë: laktozë, celulozë mikrokristalore, stearat magnezit, talk.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:



Mund të merret pa recetën e mjekut.



Nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë.



Përmbajtja. **!** Kujdes.



Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2019.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

SPECIFICATION



CROPING AREA 12 x 19 cm